

VENDIM
Nr. 424, datë 10.5.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES E TË
EMËRIMIT TË DREJTUESVE TË SHËRBIMIT NË STRUKTURAT SHËNDETËSORE
UNIVERSITARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 28, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimi në institucionet shëndetësore universitare drejtohet nga drejtuesi i shërbimit, i cili përzgjidhet në bazë konkurrimi.

2. Drejtuesi i shërbimit në momentin e kandidimit duhet të plotësojë kriteret minimale bazë, si më poshtë vijon:

- a) Të jetë mjek specialist i diplomuar në fushën e shërbimit për të cilin kandidon;
- b) Në rastet kur kandidati ka vetëm shtetësi të huaj, ai duhet të zotërojë certifikatën e mbrojtjes së gjuhës shqipe, me përjashtim të rasteve kur kandidati ka kryer një cikël të plotë studimesh në gjuhën shqipe;
- c) Të jetë i regjistruar në urdhrin profesional përkatës;

c) Të zotërojë titullin “Profesor”, “Profesor i Asociuar” ose të ketë Doktoratë/PhD, të mbrojtur në një nga universitetet e BE-së, SHBA-ve, Kanada, Australi apo Japoni. Në rast se asnjë nga pjesëtarët e stafit mjekësor nuk plotëson kriteret e sipërpërmendura, mund të pranohen edhe kandidatë me doktoratë/PhD, të mbrojtur në Shqipëri apo vende të papërmendura më sipër;

d) Të jetë mjek pedagog me kohë të plotë, me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar në IAL-në përkatëse dhe të ketë të njëjtin specialitet në shërbimin shëndetësor universitar, për të cilin kandidon, ose të jetë/të ketë qenë mjek pedagog me kohë të plotë i strukturave universitare homologe të Bashkimit Evropian ose vendeve anëtare të OECD;

dh) Të mos ketë qenë asnjëherë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë;

e) Të mos ketë asnjë dënim të dhënë nga Urdhri i Mjekut;

ë) Të ketë përvojë akademike si pedagog me kohë të plotë, jo më të vogël se 5 (pesë) vjet.

Në rastet kur asnjë nga pjesëtarët e stafit mjekësor nuk plotëson kriterin e sipërpërmendur, mund të pranohen edhe kandidatë me përvojë akademike, jo më të shkurtër se 8 (tetë) vjet, si pedagog me kohë të pjesshme. Konsiderohet përvojë akademike aktiviteti didaktik i kryer në institucione publike të arsimit të lartë apo në institucione jopublike të arsimit të lartë, të akredituara dhe në programe studimi të akredituara brenda vendit, në periudhën e përvojës së kryer. I njëjti kriter vlen dhe për institucionet dhe programet e akredituara/e njohura në një nga vendet e Bashkimit Evropian ose vendet anëtare të OECD;

f) Të ketë përvojë klinike/diagnostike jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në specialitetin përkatës.

3. Procedurat për përzgjedhjen e drejtuesit të shërbimit shëndetësor universitar nisin nga rektorati i IAL-së (UMT), me përfundimin e mandatit të radhës, me kërkesë të strukturës shëndetësore universitare përkatëse.

4. Procesi i përzgjedhjes së kandidaturave bëhet nga një komision i posaçëm, i ngritur me urdhr të përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, i cili ka në përbërje të tij një përfaqësues nga Rektorati, Dekanati i IAL-së, struktura shëndetësore universitare, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Shëndetësisë.

5. Komisioni shpall datat dhe bën publike kriteret e vlerësimit të dosjeve.

6. Komisioni organizon punën nëpërmjet sekretariatit të përbashkët me 5 (pesë) anëtarë, të cilët bëjnë verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar për çdo aplikues dhe përputhshmërinë e kriterëve të përcaktuar me këtë vendim.

7. Kandidatët për drejtues të shërbimeve aplikojnë për pozicionin përkatës për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike, duke nisur nga 1 (një) muaj para datës së konkurrimit.

8. Kërkesa shoqërohet me *curriculum vitae*, vetëdeklarimet bazuar në legjislacionin në fuqi, kopje të noterizuar të dokumentacionit përkatës provues të plotësisë së kriterëve dhe të kartës së identitetit, si dhe projektin për zhvillimin e shërbimit. Kërkesa dorëzohet pranë zyrës së burimeve njerëzore të fakultetit, pjesë e të cilit është shërbimi ku do të konkurrojnë, i cili, me përfundimin e afatit për aplikim, ia kalon dokumentacionin sekretariatit të përbashkët.

9. Kandidatët paraqiten ditën e konkurrimit për të kryer intervistën me komisionin, e cila ka për qëllim

prezantimin e projektit të kandidatit për zhvillimin dhe drejtimin e shërbimit. Projekti duhet të paraqesë të dhëna dhe produkte konkrete të matshme të cilat do të shërbejnë më pas si bazë për vlerësimin e punës së drejtuesit të ardhshëm të shërbimit që i ka paraqitur ato. Komisioni vlerëson projektin e paraqitur. Angazhimet e paraqitura nga kandidati në projekt bëhen pjesë e kontratës që kandidati lidh nëse ai shpallet fitues me strukturën shëndetësore universitare.

10. Kandidatët konkurrues për një shërbim të caktuar vlerësohen nga komisioni përkatës, sipas përcaktimeve dhe kritereve të parashikuara në aneksin nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.

11. Komisioni pas shqyrtimit bën renditjen e kandidaturave që aplikojnë për postin e drejtuesit të shërbimit shëndetësor universitar.

12. Komisioni duhet të bëjë transparente rezultatet e vlerësimit.

13. Pas miratimit, komisioni ia dërgon rezultatet e vlerësimit ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Shëndetësisë, të cilët bëjnë emërimin me shkresë të përbashkët.

14. Kandidati fitues lidh kontratën me drejtuesin e strukturës shëndetësore universitare, pjesë e të cilës është shërbimi përkatës.

15. Nëse kandidati fitues vjen nga jashtë strukturave të IAL-së, ai fiton automatikisht edhe pozicionin e pedagogut me kohë të plotë, me kontratë me kohë të pacaktuar pranë IAL-së përkatëse.

16. Drejtuesi i shërbimit drejton shërbimin për 4 (katër) vjet, me të drejtë rikandidimi.

17. Vlerësimi i punës së drejtuesit të shërbimit bëhet përmes vlerësimit të treguesve të performancës si dhe në bazë të detyrimeve kontraktore sipas parashikimeve në kontratën përkatëse të lidhur në momentin e marrjes së detyrës. Vlerësimi i punës është vjetor dhe kryhet nga drejtori i strukturës shëndetësore universitare ku shërbimi në fjalë bën pjesë.

18. Drejtuesi i shërbimit shëndetësor universitar mund të pezullohet dhe të shkarkohet nga detyra sipas Kodit të Punës apo për arsye të tjera të parashikuara me ligj. Pezullimi dhe propozimi për shkarkim mund të bëhen nga titullari i strukturës shëndetësore universitare. Shkarkimi bëhet nga ministri i Shëndetësisë dhe ministri i Arsimit dhe Sportit, me urdhër të përbashkët.

19. Në rast ndërprerjeje të parakohshme të mandatit të drejtuesit të shërbimit shëndetësor universitar, me propozim të drejtorit të institucionit mjekësor dhe rektorit të IAL-së, ministri i Shëndetësisë dhe ministri i Arsimit dhe Sportit, me shkresë të përbashkët, komandojnë në këtë detyrë një nga pjesëtarët e stafit akademik me kohë të plotë të shërbimit shëndetësor universitar përkatës. Në këtë rast, brenda 6 (gjashtë) muajve, duhet të organizohet procesi i përzgjedhjes së drejtuesit të ri të shërbimit, mandati i të cilit përfundon në të njëjtën kohë me atë të drejtuesve të tjerë të shërbimeve shëndetësore universitare të institucionit mjekësor.

20. Në rastet e IAL-ve jopublike procedurat kryhen nga IAL-ja jopublike dhe struktura shëndetësore universitare jopublike përkatëse, sipas statuteve përkatëse dhe udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

21. Shpenzimet, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga institucioni përkatës i arsimit të lartë dhe struktura shëndetësore universitare.

22. Çdo akt, që vjen në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

23. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë, institucionet përkatëse të arsimit të lartë dhe strukturat shëndetësore universitare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

ANEKSI 1

Nr.	KRITERET VLERËSUESE TË TJERA		
1	Të zotërojë titullin/gradën në fushën ku aplikon		
	Profesor		
	Profesor i Asociuar		
	PhD të mbrojtur në një nga universitetet e BE-së, SHBA, Kanada, Australi apo Japoni		
2	Përvojë drejtuese dhe rezultate pozitive në drejtimin e shërbimeve shëndetësore universitare		
3	Aftësi profesionale dhe organizative në QSUT apo struktura të ngjashme shëndetësore universitare		
4	Performanca profesionale në fushën ku aplikon		
5	Realizimi i procedurave mjekësore të veçanta (nëse aplikohet)		

6	Realizimi i operacioneve kirurgjikale të kategorisë së vështirë (nëse aplikohet)		
7	Integritet etik dhe moral, si dhe konsiderata që zotëron në komunitet		
8	Projekti 4-vjeçar i kandidatit për zhvillimin e shërbimit shëndetësor ku aplikon		
9	Specializime jashtë vendit në fushën ku aplikon		
	Afatshkurtër, ≤3 muaj, institucioni		
	Afatgjatë, >3muaj, institucioni		
10	Referime në konferenca shkencore në fushën ku aplikon		
10.1	Kategoria 1 Konferenca shkencore të shoqatave ndërkombëtare: evropiane, botërore dhe nacionale në vendet si BE, Norvegji, Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Australi		
	REFERUES ME GOJE		
	Autor i parë		
	Bashkautor		
	POSTER		
	Autor i parë		
	Bashkautor		
10.2	Kategoria 2 Konferenca shkencore të shoqatave ndërkombëtare: rajonale dhe ballkanike		
	REFERUES ME GOJE		
	Autor i parë		
	Bashkautor		
	POSTER		
	Autor i parë		
	Bashkautor		
10.3	Kategoria 3 Konferenca shkencore të shoqatave kombëtare të vendeve të rajonit që nuk përfshihen në kategorinë 1		
	REFERUES ME GOJE		
	Autor i parë		
	Bashkautor		
	POSTER		
	Autor i parë		
	Bashkautor		
11	Artikuj në revista shkencore në fushën ku aplikon		
11.1	Kategoria 1 Artikuj në revista shkencore me faktor impakti		
	Autor i parë		
	Faktori i impaktit		
	Bashkautor		
	Faktori i impaktit		
11.2	Kategoria 2 Artikuj në revista shkencore pa faktor impakti me bord editorial e ISSN në vendet evropiane, botërore dhe nacionale si BE, Norvegji, Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Australi		
	Autor i parë		
	Bashkautor		
11.3	Kategoria 3 Artikuj në revista shkencore pa faktor impakti me bord editorial e ISSN në Shqipëri dhe vendet e rajonit që nuk janë në të përfshira sipas kategorisë 1.		
	Autor i parë		
	Bashkautor		
12	Organizator i konferencave apo shkollave, kurseve shkencore edukative në fushën ku aplikon.		
12.1	Kategoria 1 Organizator i konferencave të shoqatave ndërkombëtare të organizuara në Shqipëri		
12.2	Kategoria 2 Organizator i konferencave të shoqatave ndërkombëtare të organizuara jo në Shqipëri		
12.3	Kategoria 3 Organizator i konferencave të organizuara në Shqipëri		

13	Pjesëmarrës në projekte të fushës ku aplikon		
	Drejtues		
	Pjesëmarrës		
14	Anëtar i bordeve shkencore ndërkombëtare në fushën ku aplikon		
15	Anëtar i shoqatave ndërkombëtare të profesionistëve në fushën ku aplikon		
16	Anëtar i shoqatave kombëtare të profesionistëve në fushën ku aplikon		
	Drejtues		
	Anëtar		
17	Tekst, monografi në fushën ku aplikon		
	Jashtë vendit		
	Brenda vendit të aprovuara nga Këshilli Botues i universitetit/fakultetit		
18	Çmime dhe tituj shkencore ndërkombëtarë dhe kombëtarë		
19	Arritje profesionale në fushën ku aplikon		
20	Të tjera		

